D E K R E T
Nr.1274, datë 9.11.1995

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7936, DATË 18.5.1995 "PËR TARIFAT DOGANORE"

Në mbështetje të nenit 28, pika 19 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

D E K R E T O J:

Neni 1

Në ligjin nr.7936, datë 18.5.1995 "Për tarifat doganore", në nenin 4, pas paragrafit të dytë shtohen dy paragrafë me këtë përmbajtje:

Për pajisjet e ngrohjes dhe të gatimit me gaz të lëngët ose vajguri, të gatimit të kombinuar me gaz të lëngët dhe elektrike, si dhe të gjitha llojet e bombolave që përshtaten me to, taksa doganore ndryshon nga ajo e pasqyruar në nomenklaturën, në 0 për qind.

"Për pajisjet e ngrohjes dhe të gatimit me elektrik taksa doganore ndryshon nga ajo e pasqyruar në nomenklaturën në 40 për qind.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

KUNDËRFIRMOHET
KRYEMINISTRI
Aleksandër Meksi

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
Sali Berisha